

Rregullat dhe rregulloret të Espoon Asunnot Oy (blloqet e apartamenteve)

Këto rregulla janë hartuar për të garantuar rehatinë dhe qetësinë e banorëve. Të gjithë banorët duhet që me sjelljen e tyre të marrin parasysh edhe banorët e tjerë. Banorët duhet të kujdesen që edhe miqtë e tyre t'i zbatojnë këto rregulla.

Njoftimi për ndryshim banese

Kur të largoheni nga një banesë ose kur do të transferoheni në një banesë të re, duhet të njoftoni zyrën e gjendjes civile dhe personelin kujdestar të kompanisë mirëmbajtëse për ndryshimin e adresës.

Hapësirat e përbashkëta

Dyert e jashtme të hapësirave të përbashkëta mbahen të mbyllura nga ora 21 deri në 07. Kur të përdorni dyert e jashtme, kujdesuni që ato të mbyllen. Lëvizja në hapësirat e përbashkëta duhet të jetë pa zhurmë, ndërsa qëndrimi i kotë apo pirja e duhanit në këto hapësira është e ndaluar. Rrugët e daljes nga hapësirat e përbashkëta dhe oborret duhet të jenë të pastra dhe të lira. Për arsye të rrezikut nga zjarri, plaçkat mund të ruhen vetëm në hapësirat e dedikuara për to. Ruajtja e motoçikletave të vogla dhe e mjeteve të tjera motorike në hapësirat e përbashkëta është e ndaluar. Ngjitja e tabelave apo e reklamave është e ndaluar. Vendorsja e antenave lejohet vetëm sipas udhëzimeve të Espoon Asunnot.

Vendi për larjen e rrobave

Vendi për larjen e rrobave duhet përdorur sipas rregullave për përdorimin e lavatriçeve, përcaktuar nga kompania e mirëmbajtjes së ndërtesës. Pas përdorimit vendi duhet të jetë i pastër dhe pajisjet elektrike duhet të jenë fikur. Në lavatriçe nuk lejohet larja e qilimave. Rrobat tuaja duhet t'i merrni nga dhoma e tharjes menjëherë sapo të jenë tharë. Tubi i shkarkimit të pajisjes për tharjen e rrobave duhet pastruar gjithmonë pas përdorimit.

Kujdesi për mbeturinat

Mbeturinat e pallatit dhe mbeturina të tjera duhen dërguar të paketuara në kontenerët e plehrave, duke patur parasysh edhe rregullat e klasifikimit të mbeturinave. Ndërsa për hedhjen e mbeturinave të tjera (si mobiliet e dhomës), banorët duhet të kujdesen vetë. Mbeturina të rrezikshme si bateritë e akumulatorët, enët me bojë dhe ilaçet duhen dërguar në pikat e riciklimit të HSY-së.

Parkimet

Parkimi i automjeteve lejohet vetëm në vendet e rezervuara dhe të shënuara. Parkimi për banorët lejohet vetëm në parkimet e rezervuara, ndërsa parkimi për vizitorët lejohet vetëm te parkimi për vizitorët. Parkimi për vizitorët shërben për një kohë të shkurtër parkimi. Parkimi për automjete është i rezervuar vetëm për automjetet dhe motorët që janë në përdorim. Mbajtja nderur e automjetit pa qëllim, është e ndaluar. Nëse në parkim lihet një automjet e prishur apo pjesë këmbimi të automjeteve, atëherë pronari i automjetit do të marrë një urdhërpagesë për largimin e tyre dhe/ose për shkaktim të dëmit ndaj mjedisit. Për arsye sigurie, telat e ngrohjes së automjetit

duhen hequr nga priza pas përdorimit dhe priza duhet kyçur. Parkimi i gabuar që përsëritet mund të shkaktojë edhe prishjen e kontratës së qirasë (KKO:1997:85).

Banesat

Ndalohet shqetësimi i fqinjëve. Nga ora 22 deri në 07 është koha e qetësisë së natës. Banesat duhen mbajtur me kujdes. Lajmëroni menjëherë nëse zbuloni rrjedhje të ujit dhe dëmtime në dhoma apo në hapësirat e përbashkëta. Mos hidhni mbeturina në tualet dhe as në kanalizimet e tjera të ujërave të zeza, sepse ato mund të bllokohen dhe/ose dëmtohen.

Oborret

Detyra e banorit është të mbajë pastër oborret e ndërtesës dhe të kujdeset për hapësirat e gjelbërta dhe për pastrimin e dëborës (shih kushtet e kontratës së qirasë). Ushqimi i kafshëve të egra është i ndaluar pa lejen e pronarit të ndërtesës. Ajrosja e rrobave dhe tharja e rrobave të vogla lejohet vetëm në vendet e përcaktuara për këtë qëllim.

Ballkonet

Shkundja e qilimave dhe e ndërresave të krevatit në ballkon është e ndaluar. Shkundja lejohet vetëm në vendet e rezervuara për këtë qëllim. Ajrosja e rrobave dhe tharja e tyre lejohet vetëm në litarë që vendosen poshtë parvizit të ballkonit. Është e ndaluar larja e ballkonit me ujë të rrjedhshëm. Përdorimi i skarës dhe gatimi i ushqimit në ballkon është rreptësisht i ndaluar. Nuk lejohet ushqimi i kafshëve të egra në ballkon dhe në oborret e ndërtesës.

Kafshët shtëpiake

Kafshët shtëpiake duhen mbajtur gjithmonë të lidhura kur ato janë jashtë banesës dhe ato nuk duhet të shqetësojnë banorët e tjerë. Shëtitja e kafshëve shtëpiake në zonën e ndërtesës është rreptësisht e ndaluar. Jashtëqitjet e kafshëve shtëpiake duhen mbledhur në mbajtëset përkatëse.

Pirja e duhanit në banesë dhe në ndërtesë

Të gjitha banesat

Në banesa nuk lejohet pirja e duhanit, nëse ajo ndalohet nga kontrata e qirasë. Kostot e riparimit të dëmeve nga duhani, nuk janë pjesë e konsumit normal të banesës. Kostot e riparimit të dëmeve nga duhani i faturohen banorit.

Pasi kontrata e qirasë të ndalojë pirjen e duhanit në të gjitha banesat, hyn në fuqi ndalimi i duhanit edhe në ballkon dhe në hapësirat e tjera të brendshme të ndërtesës. Për këtë do të njoftoheni veçmas kur të hyjë në fuqi rregulli.

Ndërtesat me riparim bazë pas 01/2010

Ndalohet duhani në banesa, ballkone dhe në hapësirat e brendshme të ndërtesës. Kostoja e dëmeve të shkaktuara nga duhani do t'i faturohet banorit për të gjithë shumën.

Ndërtesat e ndërtuara pas 01/2010

Ndalohet duhani përveç se në banesa edhe në ballkone e në ndërtesë, përveç vendit të rezervuar për pirjen e duhanit. Kostoja e dëmeve të shkaktuara nga duhani do t'i faturohet banorit për të gjithë shumën.

Shkelja e rregullave

Shkelja e përsëritur e rregullave mund të shkaktojë detyrimin për pagimin e kompensimit dhe/ose prishjen e kontratës së qirasë.